



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 698, datë 21.11.2023**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË LISTËN E GJYQTARËVE UDHËHEQËS TË CAKTUAR ME  
VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 466, DATË 25.07.2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61 dhe 97, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 14 dhe 33 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

- Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023 gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, duke zëvendësuar gjyqtarët udhëheqës:
  - znj. Gentiana Muçaj me gjyqtarët:
    - z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe;
    - znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarës udhëheqëse të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024);
  - znj. {...} me gjyqtarët:
    - znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarës udhëheqëse të kandidatit për magjistrat z. {...} dhe;
    - z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024)
- Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë në datën 1 dhjetor 2023.
- Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**